



Proces - Verbal nr.3.

I mbajtur sot me datë 17.12.2021, nga Inspektorët Financiarë Publik Z.Shemsi Mikli, Znj. Ermonela Sina dhe Z.Osman Loshja, me perfaqësuesit e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), përkatësisht: Z. Viktor Tushaj, ish Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së; Z. Gledian Llatja, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike; Z. Bashkim Vladi, Shef Sektori në Drejtorinë Hidrokarbure; Znj.Elda Bici, Drejtorinë Hidrokarbure; Z. Astrit Zeka, Specialist në Drejtorinë Hidrokarbure; Z. Mynyr Specialiste në Drejtorinë Ekonomike; Z. Qani Hoxha, Anëtar i marrjes në dorëzim; Z. Naim Sinanaj, Anëtar i marrjes në dorëzim; Z. Renaldo Ibrua, Anëtar i marrjes në dorëzim; Z. Kasa, Administrator, Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d, lidhur me inspektimin financiar publik të kryer në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.91, datë 05.11.2021 "Për fillimin e inspektimit financiar publik", i ndryshuar, me objekt:

a) Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me:

- Procedurat e marrjes në dorëzim të të gjitha aseteve të vendburimeve që ka patur në shfrytëzim shoqëria "TransAtlantic Albania Ltd", nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si dhe marrja në dorëzim e vendburimit Cakran-Mollaj nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007 "Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve me vendburimet Ballsh-Hekal, Gorisht-Cokul, Cakran-Mollaj"
- Procedurat e marrjes në dorëzim të sasisë së naftës, gjendje në depot /magazinat fiskale të vendburimit Cakran-Mollaj, si dhe lëvizja e kësaj sasive naftë, ndërmjet Degës së Doganës Fier dhe shoqërisë "TransAtlantic Albania Ltd", si dhe ndërmjet Degës së Doganës Fier dhe shoqërisë "Albpetrol" sh.a, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007.
- Procedurat e magazinimit të sasisë së naftës të kryera nga ana e Degës së Doganës Fier dhe nga ana e shoqërisë "Albpetrol", sh.a, si dhe procedurat e shitjes të kësaj sasive naftë në magazinat fiskale, në vendburimin Cakran-Mollaj, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007.

b) Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me:

- Dokumentimin, evidentimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve financiare të krijuara nga ana e shoqërisë "TransAtlantic Albania Ltd", kryer nga ana e Degës së Doganës Fier, si dhe nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a, gjatë dhe me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007.

c) Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me:

- Përdorimin e të ardhurave të krijuara nga shitja e sasisë së naftës, gjendje në magazinat fiskale të vendburimit Cakran-Mollaj, kryer nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për grupin e inspektimit, nga strukturat përgjegjëse të Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), rezulton:

Marrëveshja Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007 "Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin.... "Cakran-Mollaj""

- Mbi Liçensë Marrëveshjen Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin" Cakran-Mollaj".

- ✓ Me datë 04.07.2007, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, përfaqësuar prej Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), përfaqësuar nga Z. Milo Kuneshka, me detyrë Kryetar i AKBN-së dhe shoqërisë Albpetrol sh.a, përfaqësuar nga Z. Ylli Gjoni, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, është lidhur Liçensë Marrëveshje, me:
 - Objekt të Liçensë Marrëveshjes: "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin..." Cakran-Mollaj".
 - Kohëzgjatje të Liçensë Marrëveshjen Hidrokarbure: 18 muaj nga data efektive e Liçensë Marrëveshjes që përkon nga data 04.07.2007 deri datë 04.01.2009.

- ✓ Liçensë Marrëveshja Hidrokarbure datë 04.07.2007, ka në bashkëlidhje të saj Anekset respektive sa vijon:

- Aneksi "A": Zona e kontratës, Harta dhe kordinatat gjeodezike të zonës së kontratës, Blloku "Cakran-Mollaj", me 8 (tetë) kordinata "X" dhe "Y".
- Aneksi "B": Programi minimal i punës për periudhën e vlerësimit. (Referuar nenit 2 "Anekset e Liçensë marrëveshjes" të kësaj liçensë marrëveshje datë 04.07.2007).

**

- Liçensë Marrëveshja datë 04.07.2007 e lidhur ndërmjet palëve, sa më lart cituar, është miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007 "Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj dhe në vendburimet e Delvinës, ndërmjet Albpetrol sh.a dhe Stream Oil & Gas Limited".
- Më datë 04.07.2007 nga Z. Milo Kuneshka, Kryetar i AKBN-së, është nënshkruar Liçensë Marrëveshja datë 04.07.2007, në emër dhe për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE), në referencë të Autorizimit të Ministrit të METE.

- Mbi lidhjen Marrëveshjes Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin" Cakran-Mollaj".

- ✓ Me datë 19.07.2007, ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), përfaqësuar nga Z. Milo Kuneshka, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, shoqërisë Albpetrol sh.a, përfaqësuar nga Z. Ylli Gjoni, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë/Kontraktorit Stream Oil & Gas Limited, përfaqësuar nga Dr. Sotiris Kapotas, President&CEO, është lidhur Marrëveshja hidrokarbure, me:

- Objekt të Marrëveshjes/Kontratës: Për operacione vlerësimi, zhvillimi dhe prodhimi të hidrokarbureve në zonën e kontratës..." Cakran-Mollaj".
- Kohëzgjatje të marrëveshjes/Kontratës: 18 muaj nga data efektive e Marrëveshjes/Kontratës që përkon nga data 19.07.2007 deri datë 18.01.2009.

- ✓ Marrëveshja hidrokarbure datë 19.07.2007, ka në bashkëlidhje të saj Anekset respektive sa vijon:

- Aneksi "A": Zona e kontratës, Harta dhe kordinatat gjeodezike të zonës së kontratës, Blloku "Cakran-Mollaj", me 9 (nëntë) kordinata "X" dhe "Y".
- Aneksi "B": Procedura llogaritëse.
- Aneksi "C": Formë Garancie Bankare drejtuar Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).
- Aneksi "D": Programi i vlerësimit.
- Aneksi "E": Instrumenti i transferimit datë 19 Korrik 2007. (Nënshkruar nga: Z. Milo Kuneshka, Drejtor i Përgjithshëm në AKBN; Z. Ylli Gjoni, Drejtori i Përgjithshëm në shoqërinë Albpetrol sh.a; Z. Sotiris Kapotas, President&CEO i Kontraktorit Stream Oil&Gas Limited).
- Aneksi "F": Procedura e marrjes në dorëzim.

**

- Marrëveshja hidrokarbure, datë 19.07.2007 e lidhur ndërmjet palëve, sa më lart përmëndur, është miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007 "për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj dhe në vendburimet e Delvinës, ndërmjet Albpetrol sh.a dhe Stream Oil & Gas Limited".

datë 19.07.2007 nga Z. Milo Kuneshka, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në AKBN, është shkruar Marrëveshja hidrokarbure, në emër dhe për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), në referencë të Autorizimit të Ministrit të METE.
Referuar Ekstraktit historik të QKB-së datë 28.01.2021, kontraktori i kësaj Marrëveshje /Stream Oil & Gas Limited, nga data 05.10.2007 dhe deri në mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, emërtohet;

- o Kontraktori kësaj Marrëveshje/TransAtlantik Albania L.t.d, me këto të dhëna:
 - Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): K 72205016 P.
 - Data e regjistrimit: 05.10.2007
 - Emir i subjektit: Trans Atlantik Albania L.t.d-Dega shqiptare.
 - Forma ligjore: Degë e shoqërisë së Huaj.
 - Fusha e veprimtarisë; Shfrytëzim. Prodhim dhe Zhvillim i Hidrokarbureve, etj.
 - Përfaqësuesi/it ligjor i Degës/Zyrës së përfaqësimit në Shqipëri: Z. Naim Kasa, nga data 29.02.2016 deri në mbylljen e kësaj marrëveshje hidrokarbure.
 - Statusi: Aktiv.
- Marrëveshja hidrokarbure datë 19.07.2007 lidhur ndërmjet palëve, sa më lart cituar, për vendburimin Cakran-Mollaj, dokumentohet të jetë bërë efektive me datë 08.08.2007 dhe afati i kësaj marrëveshje, përkon nga data 08.08.2007 deri datë 08.02.2009. (Referuar nenit 4 "Afatet" dhe nenit 7 "Programet vjetore dhe buxhetet", nën-pika 7.3 "Periodha e vlerësimit" të kësaj licensë marrëveshje).
- Mbi mbylljen e Marrëveshjes hidrokarbure të lidhur me datë 19.07.2007 për vendburimin Cakran-Mollaj.

Referuar nenit 24 "Mbyllja", nën-pika 24.2.1, të Marrëveshjes hidrokarbure, rezulton se:

- ✓ Me shkresën nr.2268/1 Prot, datë 10.02.2016, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Endri Puka, drejtuar Ministrit të MEI, Z.Damian Gjijknuri, ka informuar mbi dhe për detyrimet e materializuara/akumuluar për shoqërinë Albpetrol sh.a nga ana e Kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, sipas marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe mbylljen e kësaj marrëveshje për këtë vendburim.
- ✓ Me shkresën nr.813 Prot, datë 10.02.2016, si dhe me shkresën nr.813/5 Prot dhe nr.813/6 Prot, datë 07.03.2016, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Endri Puka, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, mbi rikujtesën për detyrimet e materializuara/akumuluar për shoqërinë Albpetrol sh.a, sipas marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj.
- ✓ Me shkresën nr.6265 Prot, datë 19.09.2016 (protokolluar në AKBN nr.8355, datë 28.09.2016), Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Endri Puka, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, si dhe për dijeni Ministrit të MEI, Z.Damian Gjijknuri, dhe Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, Z.Tushaj, duke njoftuar: "Mbi mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe ka sjellë në vëmendje detyrimet e materializuara/akumuluar për shoqërinë Albpetrol sh.a nga Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d, ku ndër të tjera citon se: ".....duke marrë parasysh se TransAtlantik Albania L.t.d, nuk është angazhuar me qëllim korrigjimin e shkeljeve materiale të njoftuar nga Albpetrol sh.a, brenda afatit 6 mujor në zbatim të parashikimeve kontraktuale, Albpetrol sh.a, Ju njoftoj zyrtarisht mbylljen e Marrëveshjes hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj.....kjo mbyllje do të bëhet efektive në përfundim të afatit 120 ditor nga marrja e këtij njoftimi....".
- ✓ Me shkresën nr.8355/3 Prot, datë 18.10.2016 (protokolluar në Shoqërinë Albpetrol sh.a nr.6265, datë 21.10.2016), Drejtori Ekzekutiv në AKBN, Z.Tushaj, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d dhe Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Puka, si dhe për dijeni Ministrit të MEI, Z.Damian Gjijknuri, duke njoftuar: Mbi mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme për mosmarrëveshjet e lindura dhe të krijuara midis palëve ...si dhe duke marrë masa edhe për parandalimin e humbjeve ose përhapjen e hidrokarbureve mbi ose nën tokë.
- ✓ Me shkresën nr.6265/3 Prot, datë 24.10.2016, Administratori Shoqërisë Albpetrol, Z. Puka, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, si dhe për dijeni Ministrit të MEI,

Z. Damian Gjicknuri, Ministrit të Financave Z. Arben Ahmetaj, Ministrit të Znj. Milva Ekonomi, si dhe Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, Z. Viktor Tushaj, njoftuar: Mbi mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe duke sjellur vëmendje detyrimet e materializuara/akumuluar për shoqërinë Albpetrol sh.a nga Kontraktori TransAtlantia Albania L.t.d.

✓ Me shkresën nr.404 Prot, datë 20.01.2017, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Puka i është drejtuar Ministrit të MEI, Z. Damian Gjicknuri dhe për dijeni Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, Z.Tushaj, duke informuar mbi ecurinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure për vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul të lidhura me Kontraktorin TransAtlantia Albania L.t.d, ku ndër të tjera citon se: ".....TransAtlantia Albania L.t.d rezulton me detyrime përkatësisht;

- Detyrim debitor në lekë për faturat e shërbimeve të palikujduara në vlerën prej 96 494 483 lekë.
- Detyrimi debitor në USD për fatura të palikujduara në vlerën prej 13 996 426 USD, si dhe në këtë shkresë citohet: "..... Shoqërisë TransAtlantia Albania L.t.d/ish Stream Oil & Gas L.t.d, i janë krijuar më se njëherë të gjitha mundësitë për të shlyer detyrimet që ka akumuluar ndaj Albpetrol sh.a; Pamvarësisht kësaj, dhe megjithë premtimet e tyre të shumta deri më sot nuk kanë arritur as ti shlyejnë këto detyrime dhe as të paraqisnin një garanci të besueshme nga një institucion i certifikuar që të garantojë shlyerjen e tyre në një afat të caktuar.... Afati 120 ditor i përcaktuar në shkresat nr.6255 dhe nr.6266, datë 19.09.2016, është përmbushur....pra ekzistojnë të gjitha kushtet bazuar në ligjin nr.7746, datë 28.07.1993, neni 12.2 që shoqëria Albpetrol sh.a, të autorizohet të vazhdojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës së Marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul me të njëjtat kushte siç është Licensë Marrëveshjet aktuale që janë në fuqi për këto vendburime.

Në vijim:

✓ Me shkresën nr. 431/1 Prot, datë 24.01.2017 (protokolluar në AKBN nr.1007 datë 25.01.2017), Ministri i MEI, Z.Damian Gjicknuri drejtuar Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Z. Endri Puka, dhe Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së Z.Viktor Tushaj: "Mbi ecurinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure në vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul të lidhura me TransAtlantia Albania L.t.d", ndër të tjera citon: "...i) MEI shprehet se shoqëria Albpetrol sh.a, bazuar në klauzolat e ligjit nr.7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet (kërkim-prodhim)" i ndryshuar, të vazhdojë të kryejë operacione për zhvillimin dhe shfrytëzimin të hidrokarbureve në vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, në përputhje me termat e "Marrëveshja Albpetrol sh.a, si dhe ii) Merrni masa në bashkëpunim me AKBN, duke hartuar një program pune të detajuar për të vazhduar procedurat e marrjes në dorëzim të vendburimeve Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, sipas legjislacionit në fuqi që menaxhon aktivitetin hidrokarbur....; iii) rivënie në punë të puseve të ndaluar brenda një kohe sa më të shkurtër".

Për sa më lart:

**Referuar shkresës nr. 6265, datë 19.09.2016, marrëveshja Hidrokarbure datë 19.07.2007 e lidhur me Kontraktorin TransAtlantia Albania L.t.d për vendburimin Cakran-Mollaj, konsiderohet e mbyllur me datë 19.01.2017 (pasi janë konsumuar të gjithë afatet lidhur me korrigjimin në mënyrë substanciale të shkeljeve materiale të detyrave dhe detyrimeve themelore për afatin 6 muor dhe 120 ditor) dhe të gjithë pusët e naftës dhe asetet e tjera në shfrytëzim nga Kontraktori TransAtlantia Albania L.t.d, i kalojnë në administrim dhe në pronësi shoqërisë Albpetrol sh.a dhe marrja në dorëzim e tyre do të bëhet nga shoqëria Albpetrol sh.a dhe Agjensia kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) (Referuar nenit 24.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure datë 17.07.2007).

Procedurat e marrjes në dorëzim të të gjitha aseteve të vendburimeve që ka patur në shfrytëzim shoqëria "TransAtlantic Albania Ltd", nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si dhe marrja në dorëzim e vendburimit Cakran-Mollaj nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me

...509, datë 08.08.2007 "Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe
imin e hidrokarbureve me vendburimet Ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj

- Procedurat e marrjes në dorëzim të puseve dhe të gjitha asetëve të vendburimit Cakran-Mollaj nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), që ka patur në shfrytëzim shoqëria "TransAtlantic Albania L.t.d", me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga subjekti Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), rezulton se:

- ✓ Me shkresën nr.2630 Prot, datë 21.03.2017, (në zbatim të shkresës nr.431/1, datë 24.01.2017 të Ministrit të MEI Z.Damian Gjijnuri si dhe të shkresës nr.6265 datë 19.09.2016, të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Puka), Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së Z.Viktor Tushaj, ka njoftuar Kontraktorin TransAtlantik Albania L.t.d, lidhur me caktimin e përfaqësuesve nga ana e tij, për marrjen në dorëzim të asetëve, në vendburimin Cakran-Mollaj për llogari të AKBN-së.

- ✓ Me Urdhërin nr.136/6, datë 29.03.2016 (në zbatim të shkresës nr.431/1, datë 24.01.2017 të Ministrit të MEI Z. Damian Gjijnuri si dhe të shkresës nr.6265 Prot, datë 19.09.2016, të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Puka), Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së Z.Viktor Tushaj, ka urdhëruar caktimin e anëtarëve të Grupit të punës për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të asetëve të krijuara nga Kompania TransAtlantik Albania L.t.d, në vendburimin Cakran-Mollaj, me përbërje:

- Z. Gledian Llatja, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike;
- Z. Bashkim Vladi, Shef Sektori në Drejtorinë Hidrokarbure;
- Z. Astrit Zeka, Specialist në Drejtorinë Hidrokarbure;
- Znj.Elda Bici, Specialiste në Drejtorinë Ekonomike.

si dhe është urdhëruar: i) Anëtarët do të jenë pjesë e një Grupi të përbashkët me Albpetrol sh.a për vazhdimin e procedurës për marrjen në dorëzim të vendburimit Cakran-Mollaj, për asetet e shoqërisë TransAtlantik Albania L.t.d, që në bazë të Licensë Marrëveshjes "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj, i përkasin AKBN-së, si dhe ii) Ngarkohen anëtarët e Grupit të punës për zbatimin e këtij urdhëri.

Konstatohet:

- Përbërja e Grupit të marrjes në dorëzim është me numër çift dhe jo numër tek, sikurse kërkohet në aktet ligjore në fuqi "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me:
- i) Ligjit nr.10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kreu II "Përgjegjshmëria menaxheriale", Neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 1, ii) Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu I "Të përgjithshme"/ Përgjegjësia e Titullarit të njesise publike, pika 5, / Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, pika 45.
- Ngarkohet me përgjegjësi:
 - o Z. Viktor Tushaj, Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së.

- ✓ Lidhur me vijimin e procesit të marrjes në dorëzim të asetëve të TransAtlantik Albania L.t.d në vendburimin Cakran-Mollaj, rezulton se:
 - o Grupi i ngritur për marrjen në dorëzim të asetëve të TransAtlantik Albania L.t.d në vendburimin Cakran-Mollaj, i referohet një Deklarate datë 31.03.2017 (me shkrim dore) të mbajtur në zyrat e Albpetrol sh.a/Vllahinë dhe nënshkruar ndërmjet përfaqësuesve të Albpetrol sh.a/Vllahinë: Z.Kristaq Anastasi dhe Z.Bashkim Bedini dhe përfaqësuesve/grupit të marrjes në dorëzim të AKBN-së: Z.Bashkim Vladi, Z.Astrit Zekaj, Znj.Elda Bici, në të cilën citohet: "...me anë të së cilës deklarohet se të gjitha shënimet "Albpetrol" të vendosura në të gjithë listat inventarizuese janë shënuar nga përfaqësuesit e shoqërisë Albpetrol sh.a".

Konstatohet:

- Deklarata datë 31.03.2017 është hartuar dhe nënshkruar nga përfaqësuesit respektive subjekteve Albpetrol sh.a dhe AKBN-së, 2 (dy) ditë pas lëshimit të Urdhërit të Drejtuesit Ekzekutiv të AKBN-së "Për caktimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të aseteve të TransAtlantik Albania L.t.d në vendburimin Cakran-Mollaj", si dhe nuk dokumenton në bashkëlidhje të kësaj deklarate të gjithë listat inventarizuese/fletët e inventarit të aseteve të TransAtlantik Albania L.t.d me shënimet "Albpetrol", të shënuara nga përfaqësuesit e shoqërisë Albpetrol sh.a.
- Deklarata datë 31.03.2017 është nënshkruar në mungesë të përfaqësuesit të AKBN-së, Z. Gledian Llatja.
- Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me:
 - i) Ligjit nr.10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kreu II "Përgjegjshmëria menaxheriale", Neni 11 "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë", pika 3,4,5; ii) Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu I "Të përgjithshme"/ Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë, pika 10./ Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve"/Inventarizimi i aktiveve, pika 73, "Përgjegjësitë e inventarizimit", pika 85/a,b,c,86; iii) Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni 3 "Përkufizime", pika 8, gërma "a, b,c", neni 6 "Evidencat mbështetëse", pika 1, 2, neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", pika 1, 2; iv) Licensë marrëveshjen datë 04.07.2007 të lidhur mes palëve "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj", neni 17 "E drejta e pronësisë dhe shitja e pasurisë", pika 17.2; v) Marrëveshjen hidrokarbure datë 19.07.2007 të lidhur mes palëve "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj", neni 11 "Titullimi ndaj aseteve", pika 11.1.1-11.1.3; vii) shkresa e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 431/1, datë 24.01.2017 (protokolluar në Albpetrol sh.a nr.404/1, datë 24.01.2017) "Mbi ecurinë e Marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, të lidhura me TransAtlantik Albania L.t.d".
 - Urdhërin nr.136/6, datë 29.03.2017, pika 2.
 - Rregulloren e brendshme të miratuar.
- Ngarkohet me përgjegjësi:
 - o Grupi i marrjes në dorëzim: Z. Gledian Llatja, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike; Z. Bashkim Vladi, Shef Sektori në Drejtorinë Hidrokarbure; Z. Astrit Zeka, Specialist në Drejtorinë Hidrokarbure; Znj.Elda Bici, Specialiste në Drejtorinë Ekonomike.
- ✓ Në realizimin e procesit për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të aseteve të krijuara nga Kompania TransAtlantik Albania L.t.d, në vendburimin Cakran-Mollaj dhe ato të dorëzuara nga shoqëria Albpetrol sh.a, në momentin e lidhjes së marrëveshjes hidrokarbure dhe marrë në dorëzim po nga Albpetrol sh.a me datë 01.02.2017, me mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure datë 19.07.2007, për vendburimin Cakran-Mollaj, rezulton se:
 - o Grupi i marrjes në dorëzim të aseteve për këtë vendburim, ka hartuar/mbajtur 3 proces verbale të marrjes në dorëzim, përkatësisht: Proces verbali nr.1, datë 24-25.05.2017, lidhur me evidentimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve, tubacioneve, materialeve në sheshet, magazinë dhe kontenierë, në sheshin e Magazinës Ca-20; Proces verbali nr.2, datë 02.06.2017, lidhur me evidentimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve, tubacioneve, materialeve në Qendrën e Grumbullimit dhe Shitjes së naftës/Stacioni i Dekantimit me vendndodhje në Usojë, Ballsh dhe Qendrat e Prodhimit të Naftës në vendburimin Cakran-Mollaj; Proces verbali nr.3, datë 02.06.2017, lidhur me evidentimin dhe marrjen në

...dorëzim të të gjithë aseteve/pajisjeve sipërfaqësore të puseve të vendburimit Cakran-Mollaj.

Situata dhe statusi i aseteve të vendburimit Cakran-Mollaj të marra në dorëzim nga Grupi i marrjes në dorëzim të AKBN-së, referuar process verbaleve të mbajtura prej tyre, jepet si vijon:

- A) Në sheshin e Magazinës Ca-20, me vendndodhje në Cakran:
- Me Process verbalin nr.1, datë 24-25.05.2017, Grupi i marrjes në dorëzim sa sipër cituar, ka dokumentuar dhe bërë evidentimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve, tubacioneve, materialeve në sheshet, magazinë dhe kontenierë, në sheshin e Magazinës Ca-20, ku statusi i aktiveve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe të kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d të gjendura në këtë magazinë paraqitet, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Aktive		Vendndodhja	Data e marrjes në dorëzim
		Nr.	copë		
I	Shoqëria Albpetrol sh.a	12	42	Cakran	24-25.05.2017
Statusi/gjendja e tyre: 2 aktive të rregullta dhe në gjendje pune; 10 aktive, jashtë përdorimit dhe të përdorura					
II	TransAtlantik Albania L.t.d	38	5 572	Cakran	24-25.05.2017
Statusi/gjendja e tyre: 19 aktive të rregullta në gjendje pune; 19 aktive, jashtë përdorimit, dëgjur dhe të përdorura					
III	Inventari fizik i Magazinës Ca-20	316	64 034	Cakran	24-25.05.2017
Statusi/gjendja e tyre: Pa asnjë lloj statusi					
Totali:		366	69 648		

P.s: Për aktivin nr.36 "Purteka" fi22 dhe aktivin nr.38 "Rrethimi" të kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, nuk dokumentohet njësia e matjes, sasia cmimi dhe vlera e tyre.

***Proces verbali nr.1, datë 24-25.06.2017, nuk është nënshkruar nga Znj.Elda Bici, me justifikimin "Arësye shëndetësore";

Rezultoni:

- ✓ Grupi i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të aseteve/aktiveve (pajisjeve, tubacioneve, materialeve në sheshet, magazinë dhe kontenierë) të TransAtlantik Albania L.t.d dhe të Albpetrol sh. a, në sheshin e Magazinës Ca-20, dokumenton në total 366 asete/aktive në sasinë 69 648 copë.

Konstatohet:

- Proces verbali, sa më lart cituar, dokumentohet të jetë nënshkruar vetëm nga grupi i AKBN-së dhe në mungesë të përfaqësuesit/ve të kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, si dhe në mungesë të përfaqësuesit/ve të shoqërisë Albpetrol sh.a.
- Ky proces verbal nuk dokumenton në përmbajtjen e tij elementët detyrues të duhura dhe të nevojshme (ekstremitet respective) si: çmimin dhe vlerën për çdo aktiv të marrë në dorëzim, sikurse kërkohet në aktet ligjore në fuqi për këtë qëllim.
- Proces verbali, i mbajtur nga Grupi i AKBN-së, për marrjen në dorëzim të aktiveve në magazinën Ca-20 të vendburimit Cakran-Mollaj, dokumentohet të jetë i njëanshëm.

Për më tej, rezultoni:

- ✓ Dokumentohet që nga ana e grupit të verifikimit dhe marrjes në dorëzim të AKBN-së, të jetë mbajtur proces verbali nr.ska, datë 29.05.2017, mbi evidentimin fizik të inventarit të magazinës Ca-20, në zbatim të shkresës nr.431/1, datë 24.01.2017 të Ministrit të MEI Z. Gjijnuri, si dhe të Urdhërit nr.34, datë 01.02.2017 po të Ministrit të MEI Z. Gjijnuri.
- ✓ Në këtë proces verbal dokumentohet që nga grupi i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të AKBN-së, të jetë bërë verifikimi fizik i materialeve në 5 (pesë) Kontenjerët e ndodhur në sheshin e kësaj magazine, respektivisht në kontenjerin: nr.2, nr.3, nr.4, nr.5 dhe nr.7, dhe me përfundimin e verifikimit këto kontenjerë janë vulosur me vulat përkatëse.
- ✓ Dokumentohet që proces verbali datë 29.05.2017, të jetë i nënshkruar nga Grupi i AKBN-së, sipas urdhërit nr.136/6, datë 29.03.2017, përfaqësuesit e shoqërisë Albpetrol sh. a, sipas Urdhërit nr.5/1, datë 02.02.2017 dhe nr.725/1, datë 02.02.2017, si dhe përfaqësuesi i kontraktorit TransAtlantik Albania L.t. d nga Z. Laver Rrapaj, me detyrë Magazinier.

Konstatohet:

- Nga ana e kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, nuk dokumentohet të ketë zyrtare apo të jetë urdhëruar Z.Laver Rrapaj/Magazinier, i cili të përfaqësojë kontraktuesin gjatë verifikimit të materialeve në 5 kontenjerët, ndërkohë që ky person është përgjegjës për material për TransAtlantik Albania L.t.d, dhe referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi, Magazinieri është detyrimisht i përjashtuar dhe nuk duhet të jetë pjesë e grupeve/komisioneve për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të njësisë, pasi përbën konflikt të pastër interesi me funksionin që kryen;
 - Ky Process verbal dokumentohet të jetë nënshkruar në mungesë të anëtarit të grupit të verifikimit dhe marrjes në dorëzim të urdhëruar nga ana AKBN-së Znj.Elda Bici, me justifikimin "Arësye shëndetësore";
 - Ky Process verbal, nuk dokumenton në përmbajtjen e tij asnjë lloj aktivi/materiali të verifikuar apo marrë në dorëzim nga Grupi i AKBN-së, e për më tepër të dokumentojë të gjithë elementët detyrues të duhura dhe të nevojshme, si: njësi matje, sasi, çmimin dhe vlerën për çdo aktiv të ndodhur në këto 5 kontenjerë, sikurse kërkohet në aktet ligjore në fuqi për këtë qëllim.
 - Nga krahasimi i dy proces verbaleve të mbajtura lidhur me verifikimin dhe marrjen në dorëzim të aktiveve në magazinën Ca-20 Usojë, përkatësisht datë 24-25.05.2017 dhe 29.05.2017, rezulton se: Në asnjërin prej process verbaleve nuk dokumentohet verifikimi dhe marrja në dorëzim e materialeve të inventarizuara në 5 kontenjerët e Magazinës Ca-20.
 - Për sa sipër, veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me:
 - i) Ligjit nr.10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kreu II "Përgjegjshmëria menaxheriale", Neni 11 "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë", pika 3,4,5; ii) Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu I "Të përgjithshme" Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë, pika 10./ Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve"/Inventarizimi i aktiveve, pika 73, "Përgjegjësitë e inventarizimit", pika 85/a,b,c,86; iii) Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni 3 "Përkufizime", pika 8, gërma "a, b,c", neni 6 "Evidencat mbështetëse", pika 1, 2, neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", pika 1, 2; iv) Licensë marrëveshjen datë 04.07.2007 të lidhur mes palëve "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj", neni 17 "E drejta e pronësisë dhe shitja e pasurisë", pika 17.2; v) Marrëveshjen hidrokarbure datë 19.07.2007 të lidhur mes palëve "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj", neni 11 "Titullimi ndaj asetëve", pika 11.1.1-11.1.3; vi) shkresa e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 431/1, datë 24.01.2017 (protokolluar në Albpetrol sh.a nr.404/1, datë 24.01.2017) "Mbi ecurinë e Marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, të lidhura me TransAtlantik Albania L.t.d"; vii) Urdhërin nr.136/6, datë 29.03.2017, pika 2; viii) Rregulloren e brendshme të miratuar.
 - Ngarkohet me përgjegjësi:
 - o Grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: Z. Gledian Llatja, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike; Z. Bashkim Vladi, Shef Sektori në Drejtorinë Hidrokarbure; Z. Astrit Zeka, Specialist në Drejtorinë Hidrokarbure; Znj.Elda Bici, Specialiste në Drejtorinë Ekonomike.
 - o Z. Naim Kasa, Administrator, Kontraktori TransAtlantik L.t.d.
 - o Z. Laver Rrapaj, Magazinier, Kontraktori TransAtlantik L.t.d.
- ✓ Me shkresë nr.1007/2 Prot, datë 30.06.2017, AKBN drejtuar Albpetrol sh. a, ka dërguar process verbalet datë 24-25.05.2017 dhe datë 29.05.2017, mbi verifikimin dhe marrjen në dorëzim të asetëve në Magazinën Ca-20 dhe në 5 Kontenjerët e kësaj magazine.

shkresë nr.1007/3 Prot, datë 30.06.2017, AKBN drejtuar kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, ka hartuar process verbalet datë 24-25.05.2017 dhe datë 29.05.2017, mbi verifikimin dhe marrjen në dorëzim të aseteve në Magazinën Ca-20 dhe në 5 Kontenjerët e kësaj magazine.
Me shkresën nr.136/11 Prot, datë 30.06.2017, grupi i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të aseteve të TransAtlantik Albania L.t. d, në vendburimin TransAtlantik Albania L.t. d, ka hartuar Relacionin informues drejtuar Drejtorit Ekzekutiv Z. Elion Semanaj.

Rezultoni:

- Referuar korespondencës shkresore zyrtare të zhvilluar ndërmjet kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, dhe shoqërisë të AKBN-së, lidhur me statusin/ndarjen e aktiveve, gjendje në magazinën Ca-20 evidentohet se kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, ka paraqitur pranë AKBN-së listën e aktiveve, referuar shkresë nr.119/17 Prot, datë 10.08.2017 dhe shkresës nr.137/17 Prot, datë 07.09.2017, pjesë e të cilës janë edhe materialet e vendburimit Cakran-Mollaj.
- AKBN me shkresën 1007/8 Prot datë 30.08.2017 i ka kërkuar kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, si dhe shoqërisë Albpetrol sh. a, caktimin e përfaqësuesit të përfaqësuesve, lidhur me ndarjen dhe marrjen në dorëzim të materialeve, në magazinën Ca-20.
- Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d, me shkresën nr. 132/17 Prot, datë 04.09.2017 drejtuar AKBN-së, ka dokumentuar ngritjen e grupit të punës me përbërje z. Xhavit Sulaj, Z. Gazmir Aliaj dhe Z. Miti Tapia.
- Me shkresën nr.1007 Prot/11 datë 18.09.2017 drejtuar kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, dhe shoqërisë Albpetrol sh. a, është kërkuar që grupet e punës të paraqiten datë 21.09.2017 dhe 22.09.2017 pranë magazinës Ca-20, lidhur me ndarjen dhe marrjen në dorëzim të materialeve dhe pajisjeve, për vendburimin Cakran Mollaj etj.
- Titullari i AKBN-së, Z. Elion Semanaj, me urdhrin 136/13 Prot datë 18.09.2018 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për ndarjen dhe dhënien në dorëzim të të materialeve dhe pajisjeve, për magazinën Ca-20, me përbërje (Z. Qani Hoxha, Z. Mynyr Sinanaj dhe Z. Renaldo Ibrua).

Konstatohet:

- Nuk dokumentohet asnjë process verbal i mbajtur nga grupet respective të AKBN-së, kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, dhe shoqërisë Albpetrol sh. a, lidhur me ndarjen dhe marrjen në dorëzim të materialeve dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve të ndodhura në magazinën Ca-20, për vendburimi Cakran Mollaj (magazinë kjo e cila ka shërbyer për tre vendburime).
- Nga ana e strukturave përgjegjëse të shoqërisë së AKBN-së, nuk dokumentohet rregjistrimi dhe kontabilizimi të pajisjeve të ndodhura në magazinën Ca-20, për vendburimi Cakran Mollaj, e për më tej nuk dokumentohet mënyra e transferimit të këtyre pajisjeve pranë shoqërisë Albpetrol sh. A.
- Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me:
 - i) Ligjit nr.10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kreu II "Përgjegjshmëria menaxheriale", Neni 11 "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë", pika 3,4,5; ii) Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu I "Të përgjithshme"/ Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë, pika 10./ Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve"/Inventarizimi i aktiveve, pika 73, "Përgjegjësitë e inventarizimit", pika 85/a,b,c.86; iii) Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni 3 "Përkufizime", pika 8, gërma "a, b,c", neni 6 "Evidencat mbështetëse", pika 1, 2, neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", pika 1, 2; iv) Licensë marrëveshjen datë 04.07.2007 të lidhur mes palëve " Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj", neni 17 "E drejta e pronësisë dhe shitja e pasurisë", pika 17.2; v) Marrëveshjen hidrokarbure datë 19.07.2007 të lidhur mes palëve " Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj", neni 11 "Titullimi ndaj aseteve", pika 11.1.1-11.1.3; vi)

shkresa e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 431/1, datë 24.01.2017 (protokollet e Albpetrol sh.a nr.404/1, datë 24.01.2017) "Mbi ecurinë e Marrëveshjeve hidrokarbure të vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, të lidhura me TransAtlantik Albania L.t.d"; vii) Urdhërin nr.136/13, datë 18.09.2018, pika 3; viii) Rregulloren e brendshme miratuar.

- Ngarkohen më përgjegjësi:
 - o Grupit i punës për ndarjen dhe dhënie në dorëzim të të materialeve dhe pajisjeve, për magazinën Ca-20, me përbërje (Z. Qani Hoxha, Z. Mynyr Sinanaj dhe Z. Renaldo Ibrua).
- B) Në Qendrën e grumbullimit dhe të shitjes së naftës/Stacioni i Dekantimit, Usojë dhe Qendrat e Prodhimit të Naftës.
- ✓ Me proces verbalin nr.2, datë 02.06.2017, Grupi i marrjes në dorëzim sa më lart cituar, ka dokumentuar dhe bërë evidentimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve, tubacioneve, materialeve në Qendrën e Grumbullimit dhe Shitjes së naftës/Stacioni i Dekantimit me vendndodhje në Usojë, Ballsh dhe Qendrat e Prodhimit të Naftës në vendburimin Cakran-Mollaj, ku statusi i aktiveve të shoqërisë Albpetrol sh. a dhe të kontraktorit TransAtlantik Albania L.t.d, paraqiten, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Aktive		Vendndodhja	Data e marrjes në dorëzim
		Nr.	copë		
I.	QSHGN/Dekantimi-Usojë	65	155	Cakran	02.06.2017
	Pajisjet dhe ndërtesat/ Albpetrol sh a	42	88		
	Statusi/gjendja e tyre: 80 aktive të rregullta dhe në gjendje pune, 8 aktive jashtë përdorimit				
	Pajisjet dhe ndërtesat/ TransAtlantik Albania L.t.d	23	67	Cakran	
	Statusi/gjendja e tyre: 23 aktive të rregullta në gjendje pune.				
II.	Qendra e Prodhimit Ca-17	30	38	Cakran	02.06.2017
	Pajisjet dhe ndërtesat/ Albpetrol sh a	12	13		
	Statusi/gjendja e tyre: 12 aktive të rregullta në gjendje pune.				
	Pajisjet / TransAtlantik Albania L.t.d	18	25		
	Statusi/gjendja e tyre: 18 aktive të rregullta në gjendje pune.				
III.	Qendra e Prodhimit Ca-25	26	25	Cakran	02.06.2017
	Pajisjet dhe ndërtesat/ Albpetrol sh a	12	11		
	Statusi/gjendja e tyre: 11 aktive të rregullta në gjendje pune.				
	Impjanti i Jet-pompave+Të tjera/ TransAtlantik L.t.d	14	14		
	Statusi/gjendja e tyre: 11 aktive të rregullta në gjendje pune, 2 aktive jashtë përdorimit;				
IV.	Qendra e Prodhimit Ca-29	29	28	Cakran	02.06.2017
	Pajisjet dhe ndërtesat/ Albpetrol sh a	12	10		
	Statusi/gjendja e tyre: 9 aktive të rregullta në gjendje pune, 3 aktive jashtë përdorimit dhe me rrjedhje.				
